



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT
TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS

Nr. 3502/Prot.
1

Tiranë, më 18.05.2022

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1729, datë 08.10.2014.

SHOQËRISË “CHROME ASSETS AND NATIONAL CONSTRUCTION”
SH.P.K
Proptisht, Bashkia Pogradec.

Për dijëni: **AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE**
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË
MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “CHROME ASSETS AND NATIONAL CONSTRUCTION” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1729, datë 08.10.2014, për mineralin Krom, në objektin “Rodokal”, Bashkia Pogradec.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr.1927, datë 27.04.2022, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr.3502, Prot, datë 28.04.2022, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1729, datë 08.10.2014, për mineralin Krom, në objektin “Rodokal”, Bashkia Pogradec pasi nuk ka respektuar kërkesat e legjislacionit minerar lidhur me ndërprerjen e aktivitetit minerar, ku rezulton se në objekt nuk është punuar prej më shumë se një viti kalendarik.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, shkronja “c” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit** Nr.1729, datë 08.10.2014, për mineralin Krom, në objektin “Rodokal”, Bashkia Pogradec që shoqëria Juaj zotëron.

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1729, datë 08.10.2014, për mineralin Krom, në objektin “Rodokal”, Bashkia Pogradec.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU
ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI
ILIR BEJTJA

